



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 305/19
317/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Goran Milenković- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “NNP Ndriçimi” si OE “Risamont” shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull prokurimit: “Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik” me nr. të prok: 616-19-2038-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, më datën: 23. 07. 2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si te bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “NNP Ndriçimi” si OE “Risamont” shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull prokurimit: “Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik” me nr. të prok: 616-19-2038-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull “Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik” me nr. të prok: 616-19-2038-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 11.04.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 03.05.2018

Data e njoftimit me letrën standarde: 30.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim 05.06.2018

Autoriteti Kontraktues me datën 05.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Me datën: 12. 06. 2019 OE "Ndriçimi"-Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, me nr. 306/19, ndërsa me datë 14.06.2019 OE "Risamont" ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 317/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik", me numër të prokurimit:616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–KK Prishtinë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17. 06. 2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore i cili në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar:

Pretendimi ankimor i OE ankues "Ndriçimi"

Pretendimi kryesor ankimor i OE "Ndriçimi" ka të bëjë me arsyen e eliminimit të këtij OE nga ana e AK-së. AK-KK Prishtinë e ka eliminuar OE "Ndriçimi" me arsyetim se i njëjti ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta. Duhet theksuar se OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka një numër të pozicioneve me çmime jo normalisht të ulëta, ashtu siç pretendon OE ankues Ndriçimi, me gjithë atë, për dallim nga OE

ankues i cili është eliminuar mbi këtë bazë, OE tjetër është rekomanduar për dhënie të kontratës, pra AK gjatë vlerësimit të ofertave për të njëjtën çështje ka bërë vlerësim të ndryshe për dy OE të ndryshëm. Sipas nenit 7 par. 1 të LPP-së “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, në rastin konkret rregullat për çmime jo normalisht të ulëta duhet të zbatohen për të gjithë OE-të njësoj, do thotë nëse AK e sheh të arsyeshme të kërkoj sqarime për çmim jo normalisht të ulët për pozicione, atëherë të këtë duhet zbatohet për të gjithë OE-të pa dallim.

Duke u bazuar në ato që u cekën më lart, eksperti shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimorë është pjesërisht i bazuar dhe se AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 7 par. 1 të LPP-së.

Pretendimet ankimore të OE ankues “Risamond”

Pretendimet ankimore të OE Risamont fillimisht kanë të bëjnë me dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, konkretisht raportet e pranimit dhe referencat për një numër të kontratave të këtij OE.

OE ankues shpreh dyshim për falsifikim të dokumenteve nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, kjo për arsye se për një numër të kontratave sipas OE ankues, OE i rekomanduar ka ofruar: raporte të pranimit pa vulë, ka ofruar referenca për kontrata të cilat janë paraparë të përfundojnë në fund të vitit 2019, ka ofruar raporte ku numri i prokurimit dallon me numrin e prokurimit të shënuar në kontratë dhe ku numri në kontratë duket të jetë përmirësuar, se OE ka dorëzuar kontrata të vitit 2015 që i bie jashtë periudhës së kërkuar për tri vitet e fundit etj. Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimet ankimore për falsifikim, eksperti shqyrtues nuk ka kompetencë të jap konstatim në pretendime të tilla, me gjithë duke u bazuar në arsyet e dhëna nga OE ankues, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që në rast të kthimit të lëndës në rivlerësim, të obligohet AK të konfirmoj vërtetësinë e këtyre kontratave të kontestuara nga OE ankues. Kjo mund të vërtetohet duke kërkuar konfirmim me shkrim nga autoritetet kontraktuese nëse këto kontrata vërtet janë realizuar me vlerë dhe datë ashtu siç janë shënuar në listën e OE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar kontrata të lidhura me kompani private për të cilat nuk ka ofruar dëshmi –transaksione bankare, sipas LPP-së në raste të tilla AK duhet të kërkojnë dëshmi nga banka për realizimin e këtyre kontratave, mirëpo në rastin konkret kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit andaj nuk mundet të përdoret si arsye për eliminim të OE.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar katalog për shtylla të betonit, sipas dokumentacionit të gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në platformën “E-Prokurimi”, nuk kam hasur në dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalog për shtylla të betonit, andaj vlerësoj se ky pretendim ankimorë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për “Eskavator”, sipas dokumentacionit të gjetur në platformën “E Prokurimi” OE ka ofruar Kontratë për Qiramarrje me kompaninë Delta Ing për eskavator tipi “SKIP JCB”, si dhe dudin doganor në emër të kompanisë Delta Ing për pajisjen Modeli- JCB, tipi - 4CX, andaj vlerësojmë se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me stafin, OE ankues pretendon se nuk janë ofruar 10 punëtor profesional në ndriçim.

Duhet sqaruar se kërkesë e dosjes ka qenë 10 punëtor “me përvojë në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit për ndriçimin publik”, dhe jo dhe 10 punëtor “profesional në ndriçim”.

Kërkesa e AK-së “me përvojë” është shumë e përgjithshme dhe në rastin konkret nuk mundet të objektivisht të konstatohet që punëtorët fizik nuk kanë përvojë në projekte të tilla.

Andaj, përderisa nuk ka kërkesë decitive apo kërkesë për dëshmi mbi përvojën të këtyre punëtorëve, ekspertit shqyrtues konsideron se kjo nuk mund të jetë arsye për eliminim të OE në fjalë dhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit, sipas dokumentacionit të gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në platformën E-Prokurimit, në ofertën e këtij OE gjendet lista me projekte të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE.

Për dallim nga aneksi 6 dosjes së tenderit, listës së ofruar nga OE i mungon paragrafi në fund të listës ku shënon: “Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë

atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomi”.

Me qenë se lista e OE përmban të gjitha të dhënat tjera të kërkuara me aneksin 6, si dhe nënshkrimin dhe vulën e OE, si dhe faktin se OE ka dhënë edhe deklaratën nën betim, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo listë është pranueshme.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimet ankimor për çmime jo normalisht të ulëta, është e vërtetë se disa OE për disa pozicione kanë ofruar çmime që duken të jenë jo normalisht të ulëta. Eksperti shqyrtues sqaron ashtu siç kemi potencuar më lartë në përgjigje të pretendimeve ankimorë të OE “Ndriçimi”, se OE i rekomanduar për kontratë, ashtu edhe OE të tjerë për disa pozicione duket të kenë ofruar çmime jo normalisht të ulëta, mirëpo sipas nenit 61 pika 6 të LPP-së, mënyra për trajtimin e çmimeve jo normalisht të ulëta është akti nënligjorë i nxjerr nga KRPP, në rastin konkret rregullat për çmime jo normalisht të ulëta B57.

Këto rregulla duhet të zbatohen për të gjithë OE-të njësoj ku sipas nenit 4.2 të këtyre rregullave citoj:

“4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja”. Përveç kësaj pas sqarimeve të dhëna nga OE, autoriteti kontraktues sipas nenit 4.4 të këtyre rregullave duhet që :

4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

4.4.1 ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

4.4.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

4.4.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

4.4.4 origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar dhe nëse AK ka dyshime në çmimet e ofruara nga OE-të atëherë këtë problem duhet ta trajtoj sipas dispozitave ligjore nga neni 61.6 lidhur me rregullat për çmim jo normalisht të ulët, për të gjithë OE-të njësoj dhe se sqarimet e dhëna nga

OE-të duhet të jenë bindëse për AK-në në pajtim me nenin 4 të rregullave për çmim jo normalisht të ulët.

Operatori ekonomik OE ankues Risamont përmes parashtresës me shkrim të datës: 04 korrik 2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik OE ankues Ndriçimi përmes parashtresës me shkrim të datës: 04 korrik 2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 02 korrik 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi së OE i parë ankues deklaroj: “Ne qëndrojmë ne tërësi pranë pretendimeve tona ankimore. Ne këtë AP jemi eliminuar me arsyetimin se kemi ofruar çmimin jonormalisht të ulët në 6 pozicione. Kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar sepse për të gjitha këto pozicione ne kemi ofruar sqarime dhe kemi ofruar garancion se mund ti përfundojmë dhe mund ti kryejmë ashtu siç kërkohet nga AK mirëpo AK nuk i ka marr për bazë sqarimet tona. Kriter kryesor për dhënie të kontratës në këtë AP ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët i poentuar, ndërsa ne e kemi plotësuar këtë kriter kryesor për dhënie të kontratës dhe jemi renditur OE i parë me 62 poena në krahasim me ofertuesit e tjerë prandaj është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi. Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar kriterin kryesor për dhënie të kontratës dhe njëkohësisht nuk i ka trajtuar të gjitha OE njëjtë mirëpo ka favorizuar OE e rekomanduar për kontrate sepse i njëjti OE prej 51 pozicioneve që janë gjithsej në 32 pozicione ka ofruar prej 0.10 cent, ndërsa ne prej këtyre pozicioneve me këto çmime kemi ofruar në 17 pozicione. Mirëpo Autoriteti Kontraktues ka përdorur formulën e poentimit vetëm në ato 6 pozicione tona ku kemi ofruar çmime me të ulët në krahasim me çmimet e OE të rekomanduar për kontrate. Ne këtë AP mendojmë se nuk është dashur dhe është e paarsyeshme të kërkohet sqarime për pozicione për faktin se kriter kryesor ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët me poentim, ku në bazë të këtij kriteri ne jemi fitues të këtij AP. Trajtimin jo të

barabarte te Autoriteti Kontraktues e ka cekur edhe eksperti shqyrtues ne ekspertizën e tij”.

Në vazhdim kryetari i panelit i dha fjalën përfaqësuesit të OE-së së dytë ankuese z. Rexhepi i cili deklaroj: “Ne ne raportin e ekspertit shqyrtues jemi pajtuar pjesërisht. Ne njoftimin për dhënie te kontratës ne fletët për dhënie te tenderit tek kapacitetet teknike dhe profesionale nga vet Autoriteti Kontraktues është kërkuar dhe si dëshmi e kërkuar dokumentare njëkohësisht një liste e kontratave pika 1. Duke plotësuar aneksin 6 te DT-së ku duhet saktësuar titulli i kontratës shuma e kontratës, data e fillimit data e përfundimit dhe përfituesin si dhe një liste te bashkëngjiten referencat ose certifikatat e kryerjes se punëve. OE fitues nuk ka dorëzuar fare aneksin 6 por ka dorëzuar një liste te veten te kontratave. Eksperti shqyrtues ka thëna se edhe kjo liste pranohet atëherë pyetja jone është, nëse secili dokument i OE mund te ekuivalentohet me dokumentet te cilat janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues jo vetëm qe janë kërkuar por edhe ideshmi te kërkuar dokumentare plotësohet forma e DT atëherë edhe aneksi 2 deklarata nene betim paska mundësi mu ekuivalentu ne te cilën do formë te deklaratës nga OE-te. Pika e 2 qe nuk jemi pajtuar me ekspertizën ka qenë numri i kontratave i referencave dhe vlera e tyre, duke pasur parasysh qe ne kërkesën tone për rishqyrtim ne kemi evidentuar kontrata dhe referenca te cilat nuk mund te merren si te vlefshme për shkak te periudhës kohore qe janë realizuar dhe mos përputhshmërisë se referencave me kontratat përkatëse. Duke marr parasysh këtë atëherë tek kapacitetet teknike dhe profesionale pika 1. Ku thuhet qe OE duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjtë ne vlere minimale prej 300.000 euro. Gjithashtu një pike tjetër qe nuk jemi pajtuar ka qenë edhe kontratat me sektorin privat si dhe referencat te cilat nuk janë argumentuar me transaksione bankare”.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së i cili deklaroj: “Autoriteti Kontraktues KK-Prishtine ka publikuar njoftimin për kontrate lidhur me tenderin e lartcekur, gjithsej Ofertat e tyre i kanë dorëzuar 8 OE ku sipas komisionit te vlerësimit 5 OE i kanë vlerësuar si te përgjegjshëm dhe 3 si te papërgjegjshëm, Komisioni ka bërë vlerësimin e ofertave gjithnjë duke u bazuar ne LPP dhe RRUOPP. Këtë e dëshmon edhe eksperti shqyrtues ku ne gjithsej ne 7 pretendime ankimore 6 nga to i hudhe si te pabazuara.

Pretendimin 1 i OE Ndriçimi se edhe OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çmime abnormalisht te ulëta ky pretendim nuk qëndron, sepse komisioni për vlerësim te ofertave ka aplikuar formulën për analizimin për çmimet abnormalisht te ulëta, siç janë OE Ndriçimi, OE NITI dhe OE LIGHT and More ju ka kërkuar sqarime për çmime abnormalisht te ulëta. Autoriteti Kontraktues me date 27.05.2019 i ka dërguar letër standarde për çmime jonormalisht te ulëta për poz, 2,10,23,35,44 dhe 45 me çka është kërkuar analize e çmimeve për këto pozicione por nuk ka kërkuar deklarata nga OE se do ti përmbushin te gjitha obligimet sipas çmime te dhëna. OE Ndriçimi me datë 29.05.2019 ka dorëzuar sqarimet e tenderit

lidhur me çmimet jonormalisht te ulet ku ne sqarim ka dhen vetëm zotime dhe deklarate se do ta përmbushin kontratën sipas çmimeve te ofruara. Poashtu OE ka sjellur një sqarim te tenderit edhe marrëveshjen e anëtarit NTSH ONLINE ENGINEERING është distributor i kablllove turkish dhe ka garantuar se do te liferon. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarim për çmime jonormalisht te ultë qe OE te sjell analize te çmimeve e jo marrëveshje për zotime, OE ne asnjë mënyrë dhe asnjë rrethane nuk ka sqaruar çmimet jonormalisht te ulta se si janë kalkuluar me analist te çmimeve. Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit te ofertave te OE-ve krahas ofertave ka vlerësuar edhe ofertën e ankuesit me ç'rast ku kanë pasur pretendim poentim me te larte ku Autoriteti Kontraktues ka nevojë me se shumti për furnizim për poz 2, 10, 23, 35,44 dhe 45. Autoriteti Kontraktues ka përdorur formulën zyrtare për prokurim rregullore dhe udhëzuesve, formula e çmime jonormalisht te ulet OE ankimor e ka paraqitur ne 6 pozicione te poentuara me çmime shume te ulëta te lartcekura , ndërsa OE te rekomanduar vetëm ne një pozicion te ulet. Sa i përket pretendimeve ankimore te OE Risa Mont, pret. 1 se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar raport te pranimit pa vule, referencia me nr te ndryshëm e këtij pretendim nuk qëndron, OE i rekomanduar ka ofruar raporte te përfundimit te punëve te nënshkruara nga autoriteti kontraktues përkatës e poashtu lidhur me referencën qe OE ankues pretendon qe është falëse Autoriteti Kontraktues e ka konfirmuar dhe e ka vërtetuar se ajo reference është valide dhe si dëshmi kemi shkresat me autoritetin qe ka lëshuar atë referencë, po ashtu edhe pretendimi 2 se OE ka ofruar kontrate lidhur me kompaninë private por nuk ka ofruar transaksione bankare edhe ky pretendim nuk qëndron për arsye se nuk ka qenë kërkesë e kërkesave ne DT dhe këtë e dëshmon edhe eksperti. Pretendimi nr 3 se OE i rekomanduar nuk ka ofruar katalog për shtyllat te betonit poashtu nuk qëndron për arsye se ne kërkesat teknike ne njoftimin për kontrate kriter është qe OE duhet ta sjell katalogun për shtylla dhe drita e qe nuk ceket askund për shtylla betoni, OE ka ofruar katalog për shtylla te hekurit e ato janë pjese e paramasa. Pretendimi 4 se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dëshmi për eskavator edhe ky pret, nuk qëndron këtë e dëshmon edhe raporti i ekspertit për arsye se OE ka ofruar kontrate me OE Delta ING me çka këtë paisje e ka dëshmuar me dud doganor. Pretendimi 5 lidhur me atë se nuk janë ofruar 10 punëtor profesional ne ndriçim edhe ky pret, nuk qëndron. Ne kriteret e kërkuar janë kërkuar 1 inxhinieri te elektrikes me përvoja 3 vjeçare pas diplomimit dhe 10 punëtor ne zgjerimin e rrjetit për ndriçim publik qe është dashur te vërtetohet me dëshmi, apo marrëveshje për angazhim ne këtë projekt, OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar edhe dëshmitë për 10 punëtoret e kërkuar me dëshmi kontratat e punës siç janë kërkuar. Pretendimi 6 se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka plotësuar aneksin 6 nuk qëndron për arsye se secili OE e ka mënyrën e vet te pune dhe lista qe ka ofruar OE i përmban te gjitha te dhënat qe kërkohen ne aneksin 6".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z. Halili deklaroj: “Qëndroj prapa raportit të ekspertizës. Pyetje nga OE “Ndriçimi” për përfaqësuesin e autoriteti kontraktues perse është caktuar kriteri kryesor për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët të poentuar dhe a është bazuar ky kriter nga ana e Autoriteti Kontraktues.

Përgjigja e përfaqësuesit të Autoriteti Kontraktues: “Këtë për arsye se një paramasë kur jepet për çmimin njësi ajo duhet të jetë e poentuar për të pasur mundësi që të bëhet një njoftim për kontratë me çmime njësi poashtu për pozicionet të cilat janë me të rëndësishme ekspertet e asaj lëmie e vlerësojnë rëndësinë dhe peshën e atij pozicioni edhe jam i bindur që Autoriteti Kontraktues e ka zbatuar me përpikëri këtë kriter.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese deklaroj: “Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të pranohet ankesa jone si e bazuar dhe ky AP të kthehet në rivlerësim dhe të zbatohen kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese deklaroj: “Kërkojmë që ky AP të kthehet në rivlerësim duke marrë për bazë të gjitha pretendimet tona ankimore”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: “Autoriteti Kontraktues duke u mbështetur në të gjitha këto të dhëna kërkon nga paneli që ta aprovon vendimin e Autoriteti Kontraktues dhe të hudhë poshtë ankesat e OE-ve Ndriçimi dhe Risamont”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim konstaton se OE “Ndriçimi” është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetim se i njëjti ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta mirëpo paneli shqyrtues konstaton se edhe OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka një numër të pozicioneve me çmime jo normalisht të ulëta, ashtu siç pretendon OE ankues “Ndriçimi”, me gjithë atë për dallim nga OE ankues i cili është eliminuar mbi këtë bazë, OE tjetër është rekomanduar për dhënie të kontratës, pra AK gjatë vlerësimit të ofertave për të njëjtën çështje ka bërë vlerësim të ndryshe për dy OE të ndryshëm. Sipas nenit 7 par. 1 të LPP-së “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, në rastin konkret rregullat për çmime jo normalisht të ulëta duhet të zbatohen për të gjithë

OE-të njësoj, do thotë nëse AK e sheh të arsyeshme të kërkoj sqarime për çmim jo normalisht të ulët për pozicione, atëherë të këtë duhet zbatohet për të gjithë OE-të pa dallim. Duke u bazuar në ato që u cekën më lartë paneli shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar dhe se AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 7 par. 1 të LPP-së.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE “Risamont” që ka të bëjë me dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, konkretisht raportet e pranimit dhe referencat për një numër të kontratave të këtij OE, ku OE Risamont shpreh dyshim për falsifikim të dokumenteve nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, kjo për arsye se për një numër të kontratave sipas OE ankues, OE i rekomanduar ka ofruar: raporte të pranimit pa vulë, ku sipas OE ankues ka ofruar referenca për kontrata të cilat janë paraparë të përfundojnë në fund të vitit 2019, ka ofruar raporte ku numri i prokurimit dallon me numrin e prokurimit të shënuar në kontratë dhe ku numri në kontratë duket të jetë përmirësuar, se OE ka dorëzuar kontrata të vitit 2015 që i bie jashtë periudhës së kërkuar për tri vitet e fundit etj, paneli shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin ankimor për falsifikim, autoriteti kontraktues është i obliguar që gjatë rivlerësimit konform 72 dhe 59.2 ta vërtetojë se ka pasur falsifikim të dokumenteve nga OE i rekomanduar për kontratë.

Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar kontrata të lidhura me kompani private për të cilat nuk ka ofruar dëshmi –transaksione bankare, duke u bazuar në ligjin për prokurim publik paneli shqyrtues vlerëson se në raste të tilla AK duhet të kërkojë dëshmi nga banka për realizimin e këtyre kontratave, mirëpo në rastin konkret kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit andaj nuk mundet të përdoret si arsye për eliminim të OE.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar katalog për shtylla të betonit, sipas dokumentacionit të gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në platformën “E-Prokurimi”, nuk është hasur në dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalog për shtylla të betonit, andaj këtë pretendim ankimor paneli shqyrtues e vlerëson si të bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për “Eskavator”, sipas dokumentacionit të gjetur në një platformë “E Prokurimi” OE ka ofruar Kontratë për Qiramarrje me kompaninë “Delta Ing” për eskavator tipi “SKIP JCB”, si dhe dudin doganor në emër të kompanisë “Delta Ing” për pajisjen Modeli- JCB, tipi - 4CX, andaj paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me stafin ku OE ankues pretendon se nuk janë ofruar 10 punëtor profesional në ndriçim. Paneli sqaron se kërkesë e dosjes ka qenë 10 punëtor “me përvojë në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit për ndriçimin publik”, dhe jo dhe 10 punëtor “profesional në ndriçim”. Kërkesa e AK-së “me përvojë” është shumë e përgjithshme dhe në rastin konkret nuk mundet të objektivisht të konstatohet që punëtorët fizik nuk kanë përvojë në projekte të tilla. Andaj, përderisa nuk ka kërkesë decitive apo kërkesë për dëshmi mbi përvojën të këtyre punëtorëve, paneli shqyrtues konsideron se kjo nuk mund të jetë arsye për eliminim të OE në fjalë dhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit, sipas dokumentacionit të gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në platformën E-Prokurimit, në ofertën e këtij OE gjendet lista me projekte të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Për dallim nga aneksi 6 dosjes së tenderit, listës së ofruar nga OE i mungon paragrafi në fund të listës ku shënon: “Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik”. Me qenë se lista e OE përmban të gjitha të dhënat tjera të kërkuara me aneksin 6, si dhe nënshkrimin dhe vulën e OE, si dhe faktin se OE ka dhënë edhe deklaratën nën betim, paneli shqyrtues vlerëson se kjo listë është pranueshme.

Lidhur me pretendimin ankimor për çmime jo normalisht të ulëta, paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë, ashtu edhe OE të tjerë për disa pozicione duket të kenë ofruar çmime jo normalisht të ulëta, mirëpo sipas nenit 61 pika 6 të LPP-së, mënyra për trajtimin e çmimeve jo normalisht të ulëta është akti nënligjor i nxjerr nga KRPP, në rastin konkret rregullat për çmime jo normalisht të ulëta B57.

Këto rregulla duhet të zbatohen për të gjithë OE-të njësoj ku sipas nenit 4.2 të këtyre rregullave citoj: “4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja”. Përveç kësaj pas sqarimeve të dhëna nga OE, autoriteti kontraktues sipas nenit 4.4 të këtyre rregullave duhet që :

4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

- 4.4.1 ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- 4.4.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- 4.4.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- 4.4.4 origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Andaj paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar dhe nëse AK ka dyshime në çmimet e ofruara nga OE-të atëherë këtë problem duhet ta trajtoj sipas dispozitave ligjore nga neni 61.6 lidhur me rregullat për çmim jo normalisht të ulët, për të gjithë OE-të njësoj dhe se sqarimet e dhëna nga OE-të duhet të jenë bindëse për AK-në në pajtim me nenin 4 të rregullave për çmim jo normalisht të ulët.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – KK Prishtine
- 1x1 OE ankues
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.